



Babai i Adnan Januzaj ka folur per here te pare per mediat kosovare duke rrefyer me ne fund te verteten. "FSHF nuk ka kontaktuar. Do te presim nie mundesi tjeter. FSHF ja ka mbyllur deren vetes. Me Duken nuk do te flas. Njerez jo te singerte prane federates kane bere deklarata te paverteta. Megjithate ne nuk ja mbyllim deren Shqiperise se jemi shqiptare por me kete federate me besoni qe nuk do te negociojme. Presim te negociojme me njerez profesionale", ka thene babai i Januzajt duke i dhene nje shuplake te forte te gjithe shpresave kuqezi per te pare talentin e Manchester United te luaje per Shqiperine.